A.K.P.A.
Nr 2889 Prot.
Datë,më 02.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KOLIN GJOKA"LEZHË

Nr. 1013 prot. Data 29.10.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr 4 date 18.08.2025 per disa shtesa dhe ndryshime ne udhezimin nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"i ndyshuar, dhe udhëzimin nr. 3, datë 7.2.2025 "Për marrjen në punë të punonjësve me kohë të pjesshme, në qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale",

Shkolla Profesionale "Kolin Gjoka", ju njofton krijimin e 1 (nje) vendi të lirë pune për pozicionin:

- Mësues të formimit teorik , drejtimi Hoteleri-Turizem,Ekonomik,TIK,Teknologji Ushqimore,Sherbime Sociale Shendetesore, me kohë të pjesshme (8 ore/jave) ,1 (nje) person.(Inxhinier mjedisi)

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kritere të përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shendetesore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës se prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit;

Adresa;Lagjia Beselidhja; Rruga; Kosova' Lezhe : cel ;0682577245; Bardh.Dedgjonaj@akpa.gov.al

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlershme me të, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- Të ketë të paktën 1 (nje) vit eksperience pune në fushën në të cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit,e cila përmban dokumetacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë të përfshijë:

- Letër motivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin(CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet,trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënëst e mëparshëm.
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 09.11.2026

3. Vleresimi i kandidateve do behet referuar percaktimeve te udhezimit nr 759,date 27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",i ndryshuar.

DREJTORI

Bardh DEDGJONAJ



Adresa;Lagjia Beselidhja; Rruga; Kosova' Lezhe : cel ;0682577245; Bardh.Dedgjonaj@akpa.gov.al